




HAPEN JAVËT KULTURORE NDËRKOMBËTARE, 18 SHTETE SJELLIN KULTURËN NË SHQIPËRI

Nën një atmosferë festive, mes të ftuarish nga vende të ndryshme të botës u hapën në Sheshin Skënderbej Javët Kulturore Ndërkombëtare. Një iniciativë, e cila po realizohet nën kujdesin e posaçëm të kryeministrit Edi Rama, me synimin kryesor atë të hapjes së dyerve të Shqipërisë për kulturën nga e gjithë bota, si një nga format më të mira për të promovuar vendin tonë. Motoja e këtyre javëve është: Shqipëria mikpret botën! Do të jetë një paradë ku marrin pjesë 17 vende, plus Bashkimin Europian, si një ndërthurje e të gjitha kulturave nën flamurin e familjes së madhe europiane. Të parët që hapin këtë udhëtim janë francezët, për

**MOTOJA E KËTYRE
JAVËVE ËSHTË: SHQIPËRIA
MIKPRET BOTËN!
DO TË JETË NJË PARADË KU
MARRIN PJESË 17 VENDE,
PLUS BASHKIMIN EUROPIAN, SI
NJË NDËRTHURJE E TË GJITHA
KULTURAVE NËN FLAMURIN
E FAMILJES SË MADHE
EUROPIANE**

të vijuar me Bashkimin Europian; më pas Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Greqia, Italia, Izraeli, Spanja, Britania e Madhe, Suedi, Egjipti, Kinë, Gjermani, Japoni, Austri, Turqi, Hungari, Emiratet e Bashkuara Arabe, duke e përmbyllur me një festë, me rastin e Festave të Nëntorit me Kosovën. Do të jetë kjo një festë tërësisht shqiptare, që jo rastësisht është planifikuar në atë periudhë me ngjyra të forta identitare. Programi do të jetë i larmishëm. Do të ketë shumë kulturë, trashëgimi (muzikë, kërcim, arte pamore, arkitekturë, arkeologji, kinema, letërsi, seminare, konferenca...), por edhe kulinar apo organizime në fushën e ekonomisë e tregtisë, sportit dhe teknologjisë.

SHQIPËRIA ME LUMTURI BLOSHMIN NË BIENALEN E VENECIAS



Në datën 21 prill u hap në hapësirat e Arsenales në Bienalen Ndërkombëtare të Venecias, pavijoni shqiptar, prezantuar me artisten Lumturi Blloshmi, kuruar nga Adela Demetja, titulluar "Nga e para". Në këtë edicion të 59-të Shqipëria vjen për herë të parë me një ekspozitë personale të një artisteje grua dhe që nuk jeton më. Ceremoninë e hapjes e përshëndeti Ministria e Kulturës, Elva Margariti, e cila ndër të tjera u shpreh se "Lumturi Blloshmi është simboli i tejkalimit të çdo lloj vështirësie që të përball jeta.

LEA YPI, FITUESE E ÇMIMIT "LUMO SKËNDO" 2021



Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit ndau çmimin "Lumo Skëndo" 2021, kushtuar librit më të mirë në lëmin e studimeve, eseistikës apo publicistikës, në nder të emrit të pasuesit të Rilindasve Mid'hat Frashëri. Juria vlerësoi si veprën më të mirë "Të lirë", të autores Lea Ypi. Vepra spikati "për vlerat e shquara në trajtesën origjinale, artistike e filozofike të konceptit të lirisë në kohën e diktaturës komuniste dhe të tranzicionit demokratik në Shqipëri, nëpërmjet kujtimeve të fëmijërisë dhe adoleshencës, dhënë me vërtetësi, sinqeritet, ndjeshmëri e humor".

MENAXHIMI I PARKUT TË BUTRINTIT, NISIN DISKUTIMET NË KOMISIONET PARLAMENTARE

Pas miratimit në Këshillin e Ministrave, Ministria e Kulturës ka nisur diskutimin e projektligjit "Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit" në komisionet përkatëse parlamentare. Seancat e para u shoqëruan me debate të forta me përfaqësuesit e opozitës. Përkundër çdo dyshimi, keqinformimi dhe keqdashjeje, Ministria e Kulturës, Elva Margariti ka sqaruar se:

Plani i ri i Menaxhimit të Butrintit vjen si kërkesë ligjore, në përbushje të të gjitha rekomandimeve të UNESCO-s dhe duke huazuar modele të suksesshme menaxhimi të siteve të rëndësishme në botë, nga Italia, Londra, Franca e Amerika.

Ky plan parashikon administrimin përmes një fondacioni të posaçëm, i themeluar nga Ministria e Kulturës dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, ku Ministria jo vetëm është e mirëpërfaqësuar në bordin drejtues, por ka tagrin të kontrollojë veprimtarinë e Fondacionit. Fondacioni është shqiptar, funksionon sipas Ligjit të OJF-ve, pra është jofitimprurës. Duke hedhur poshtë çdo pretendim se shteti shqiptar po e jep Parkun Kombëtar të Butrintit me konçension.

Butrinti ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë pronë e shtetit dhe do të vazhdojë të administrohet nga shteti në bashkëpunim me një fondacion të besueshëm, që në Shqipëri ka realizuar projekte të suksesshme. Çdo qindarkë e Butrintit mbetet në Butrint, dhe gjithashtu një përqindjeje që kontribuon në arkën e Fondit të Trashëgimisë, në ndihmë të siteve të tjera.

Plani i ri i menaxhimit rrit mundësinë e investimeve në kërkim shkencor, restaurim, konservim, shtim të shërbimeve për vizitorët e për vetë stafin, ashtu si edhe përmirësim dhe modernizim të infrastrukturës në ndihmë të Parkut e të vetë komunitetit lokal.

Arkës së Butrintit prej 2 milionë dollarësh, që i faturohen shtetit shqiptar si investim, i shtohen edhe 5 të tjerë nga AADF.

Dhe çdo investim që do të bëhet në Butrint do t'i mbetet shtetit shqiptar. Hartimi i këtij plani është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin, specialistët e fushës dhe institucionet përgjegjëse. Përmes nënshkrimit të një protokoll bashkëpunimi me Institutin e Arkeologjisë do të çohen përpara kërkimet shkencore përmes ngritjes së qendrës kërkimore, Butrinti Research Group, gërmimet arkeologjike, restaurimet e konservimit.

Mbrojtja e mjedisit, florës dhe faunës është një nga pikat kyçe në këtë menaxhim të ri, duke vënë në jetë filozofinë "carbon free", duke shmangur trafikun e automjeteve dhe duke vënë në qarkullim për transportin e vizitorëve nga qendra e pritjes deri në park, mjete që nuk ndotin ajrin. Çdo marrëveshje në emër të Butrintit është bërë në funksion të ruajtjes dhe promovimit të këtij Parku Kombëtar nën mbrojtjen e UNESCO-s, për ta kthyer në një lider të trashëgimisë kulturore e turistike në rajon. Ministria e Kulturës ka treguar në këto vite se është tërësisht e angazhuar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, duke pasur në thelb të punës së saj transparençën dhe të mirën kombëtare.

**PLANI I RI I MENAXHIMIT RRI
MUNDËSINË E INVESTIMEVE
NË KËRKIM SHKENCOR,
RESTAURIM, KONSERVIM,
SHTIM TË SHËRBIMEVE
PËR VIZITORËT E PËR VETË
STAFIN, ASHTU SI EDHE
PËRMIRËSIM DHE MODERNIZIM
TË INFRASTRUKTURËS NË
NDIHMË TË PARKUT E TË VETË
KOMUNITETIT LOKAL.**

KULTURA 2022



Nr.1
JANAR

kultura.gov.al



PËRFUNDON RESTAURIMI I KISHËS SË KEPIT TË RODONIT, U DËMTUA NGA TËRMETI



Përfundojnë punimet restauruese në Kishën e Shën Ndoit, në Kepin e Rodonit. Pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, kisha e Shën Ndoit, një prej monumenteve të rralla të llojit të vet, rrethuar nga një peizazh mahnitës, ishte një nga objektet e dëmtuara nga lëkundjet sizmike, e cila u klasifikua si një nga monumentet e listës prioritare të programit prej 40 milionë

PALLATI I BRIGADAVE HAPET PËR PUBLIKUN

Ministria e Kulturës zhvilloi në ambientet e Pallatit Presidential (Pallati i Brigadave) konsultimin publik për hartimin e Planit të Menaxhimit të Integruar, të kësaj hapësire, shpallur “Ansambël Historik” dhe “Zonë e stimuluar”; me Vendim të Këshillit të Ministrave, në vitin 2004. Të pranishëm ishin specialistë të trashëgimisë kulturore, ministra, rektorë universitetesh, arkitektë etj. Në fjalën e saj, Ministria e Kulturës, Elva Margariti u shpreh se “Bashkë me Universitetin Politeknik të Tiranës, në kuadrin e “Paktit për Universitetin” kemi ndërmarrë hapin e hartimit të një Plani Menaxhimi të Integruar për Pallatin Presidential. Synimi ynë është që potenciali kulturor, turistik, ekonomik që ngërthen ky ansambël, njëkohësisht edhe “Zonë e stimuluar” të rrezatojë dhe të reflektohet në të gjithë zonën përreth, duke harmonizuar të gjitha investimet e qeverisë dhe të pushtetit lokal. Duke e kthyer këtë hapësirë në një pol të rëndësishëm zhvillimi

PREZANTOHET PLANI I MENAXHIMIT

pë zonën përreth”. Më tej Ministria Margariti u shpreh: “Të konservosh dhe të rrijtësosh është një sfidë, por jam e bindur se do të gjejmë formulën e duhur që do të mundësojë shtimin e shërbimeve dhe funksioneve pa cenuar vlerat historike, arkitektonike të monumentit, dhe peizazhit rreth tij; të stimulojnë potencialin turistik që ka ky sit, por edhe ta kthejmë në një destinacion edukues për fëmijët, për të cilët do të ngrihen programe të dedikuara. Pallati Presidential nuk mund të jetë vetëm një muze i vetvetes, por nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm, të mund të arrijë të gjenerojë të ardhura për të siguruar vazhdueshmërinë e ruajtjes, konservimit dhe restaurimit të tij.

40

MILIONË EURO
ËSHTË FONDI I PROGRAMIT
TË BASHKIMIT EUROPIAN,
EU4CULTURE.

eurosh të Bashkimit Europian, EU4Culture. Ndërhyrjet, të cilat u mundësuan prej një investimi prej rreth 90.000 eurosh, konsistojnë në ndërhyrje konsoliduese emergjente; restaurimin e dyshemesë; pastrimin e sistemit të kullimit dhe drenazhimit; realizimi i instalimeve elektrike të brendshme dhe të jashtme; sistemim të jashtëm etj. Ndërhyrjet më të fundit në këtë monument janë kryer në vitin 2000 me fonde të Republikës Federale të Gjermanisë. Më herët, në vitin 1978, me zbulimin e rrënojave, filloi menjëherë dokumentimi i tyre dhe disa konsolidime pjesore. Pas përfundimit të restaurimit të pikturave murale, kisha do të rinisë shërbesat e saj fetare, por edhe do të presë e përcjellë turistë.

U PËRURUA XHAMIA E ET'HEM BEUT, IU RIKTHYE BESIMTARËVE



Pas një pune trevjeçare u përrua në Tiranë Xhamia simbolike e Et'hem Beut, një investim i Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA). Ceremonia e përrimit të Xhamisë u zhvillua në datën 17 janar, me praninë e Presidentit të Republikës së Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, kryeministrit shqiptar Edi Rama dhe personalitete të larta shtetërore të të dy vendeve. E ndërtuar mes viteve 1793-1823, Xhamia e Et'hem Beut është një objekt i rëndësishë së

NJË NGA NDËRHYRJET MË DELIKATE DHE TË VËSHTIRA ISHTE PADYSHIM RESTAURIMI I PIKTURËS MURALE, E CILA ZË NJË HAPËSIRË PREJ 500 METRASH KATRORE.

veçantë, me vlera historike, arkitektonike e shpirtërore. Ndërrhyrjet e realizuara konsistonin në drenazhimin e themeleve në

gjithë perimetrin; përrforcimin e bazamentit të minares; hidroizolimim të themeleve; restaurimi total i minares dhe veshja me plumb e fundit të saj; veshja e kubesë me plumb; restaurimi i çatisë; i sistemit hidraulik dhe elektrik etj. Por një nga ndërhyrjet më delikate dhe të vështira ishte padyshim restaurimi i pikturës murale, e cila zë një hapësirë prej 500 metrash katrorë. Tashmë ajo ka dalë në dritë me gjithë madhështinë e saj dhe pret besimtarë e vizitorë.



BOTOHET DITARI I KARRIERËS SË AKTORES TINKA KURTI

U promovua në Tiranë libri "Tinka Kurti-Ditari i një bashkëshorti" i autores Anila Mema, mbështetur nga Ministria e Kulturës dhe Bashkia e Tiranës. Libri është dëshmia e një jete plot sakrificë e një prej përfaqësuesve kryesore të një plejade artistësh të jashtëzakonshëm, që themeluan artin skenik dhe atë kinematografik në Shqipëri. Është një copëz historie e kinematografisë shqiptare dhe një guidë për artistët e rinj. Në shenjë falenderimi për kontributin e saj të vyer shumëvjeçar, Ministria e Kulturës, Elva Margariti i dhuroi një simbol mirënjohjeje, një copëz shkëmb, ashtu si ajo ka përballuar jetën dhe karrierën.

RIJETËSOHET KULLA VENECIANE NË DURRËS, KTHEHET NË QENDËR INFORMIMI

Nisi puna për rijetësimin e Kullës Veneciane në Durrës. Restaurimi dhe rijetësimi i këtij monumenti do të mundësohet nëpërmjet programit EU4Culture, me një vlerë prej afro 690.000 eurosh. Hapi i parë i ndërhyrjeve është hidroizolimi i çatisë. Më tej, fasada e Kullës do t'i nënshtrohet pastrimit të kujdesshëm nga bimësia dhe papastërtitë. Në brendësi të Kullës do të realizohet nxjerrja në dritë e dyshemesë autentike prej guri, e cila do të konservohet dhe restaurohet. Objekti do të pajiset me sisteme të reja mekanike, elektrike dhe pajisje teknologjike.

690.000

EURO

DO TË KUSHTOJË
RIJETËSIMI I KULLËS
VENECIANE NË DURRËS

"ZGJOI", NJË FILM I MBËSHTETUR NGA QKK DHE MINISTRIA E KULTURËS DREJT ÇMIMIT OSCAR

Për herë të parë një film artistik me metrazh të gjatë, i financuar edhe nga Qendra Kombëtare Kinematografike e Shqipërisë dhe mbështetur nga Ministria shqiptare e Kulturës hyn në listën e shkurtër të kandidatëve për çmimin Oscar, në kategorinë e filmit të huaj. Bëhet fjalë për filmin artistik "Zgjoji" ("Hive") me regji të Blerta Bashollit, një bashkëprodhim mes Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Zvicrës, i cili bën pjesë në listën e ngushtë të 15 prodhimeve ndërkombëtare për edicionin e 94-të të çmimit Oscar.